

Zhvillimi i kulturës së të folurit e të shkruarit tek nxënësit e ciklit të ulët përmes rubrikave të ndryshme

Cështjet:

1. Rëndësia e punës me fjalorin
2. Veçoritë e punës në rubrikat “Bisedojmë së bashku”, “Fjalori” .
3. Puna e mësuesit me termat. Metoda e shpjegimit të fjalëve të reja.
4. Puna me fjalorin dhe ligjëratën e nxënësve edhe në veprimtaritë jashtëshkollore

1. Rëndësia e punës me fjalorin

Zhvillimi i të folurit me gojë e me shkrim i nxënësve të ciklit fillor është njëri nga drejtimet kryesore të punës në mësimin e gjuhës shqipe. Puna për pasurimin e fjalorit të nxënësve është e lidhur ngushtë me realizimin e një vargu detyrash të tjera mësimore e edukative. Nëpërmjet bisedave që zhvillohet në bazë të figurave, të tablove ose të objekteve në natyrë, nxënësit mendojnë se si duhet t’i vërejnë ato në tërësi dhe në veçanti, si t’i dallojnë e t’i përshkruajnë sendet e dukuritë, si t’i vlerësojnë, t’i emërtojnë, të flasin për formën, madhësinë, ngjyrën, dobinë, dëmin etj.. Të njohin kuptimet e para dhe të dyta të tyre, të krijojnë fjali, të bëjnë përshkrime, krahasime, tregime etj. Gjatë mësimave për zhvillimin e të folurit nxënësit zgjerojnë horizontin e tyre kulturor, zhvillojnë aftësitë për të menduar në mënyrë të pavarur e për të mbajtur qëndrim, për sendet, dukuritë që vëzhgojnë dhe në këtë mënyrë shkallë-shkallë formojnë edhe botëkuptimin e tyre shkencor. Përmes vëzhgimeve e bisedave përftohen tek nxënësit ndjenjat dhe emocionet, aftësia për të mbajtur qëndrim ndaj së mirës dhe së keqes, të bukurës dhe të shëmtuarës. Duke u njohur me gjithë pasurinë dhe larminë e mjeteve shprehëse, nxënësit fitojnë shprehje dhe bëhen të aftë për t’i shprehur drejt e me lehtësi mendimet me gojë e me shkrim.

Programi mësimor i kushton një vëmendje të veçantë punës me fjalorin dhe ligjërimin me gojë. Në klasën e parë, sikurse dihet, mësimi i gjuhës amtare nuk bëhet në orë të veçanta, po nëpërmjet gjithë punës, që zhvillohet në periudhën e shkrim-leximit. Kurse, për klasat e tjera, në përshtatje me moshën dhe programin, është parashikuar që pothuajse çdo orë, por edhe në orë të veçanta, t’u jepen nxënësve elementet themelore leksikore, frazeologjike e drejtshqiptimore të gjuhës së sotme letrare shqipe. Në program kërkohet që këto njohuri të zgjerohen, të ushtrohen e të përforcohen vazhdimisht.

Mësuesi e vë theksin në të dyja anët e punës, për të zhvilluar gjuhën e folur dhe të shkruar, edhe në anën teorike edhe në atë praktike. Kërkohet që nxënësit, në mënyrë të veçantë të aftësohen që t’i shkruajnë dhe t’i shqiptojnë drejt fjalë, të jenë në gjendje që në të folur e në të shkruar të zbatojnë normën e gjuhës letrare, të mbajnë qëndrim veprues ndaj dukurive gjuhësore dhe t’i përdorin mjetet shprehëse të gjuhës drejt e me lehtësi në përshtatje me rrethanat e ligjërimin, me kërkesat e stilit. Këshillohet që gjithashtu për qëllime ushtrimi, në mësim të përdoren përveç materialeve ilustruese edhe pjesë të zgjedhura nga letërsia artistike. Gjatë orës së mësimin, nxënësve u kërkohet të mësohen të

vëzhgojnë ilustrimet e tekstit sipas udhëzimeve të mësuesit, të emërtojnë objektet, të krijojnë fjali të bukura, t'u përgjigjen pyetjeve, të zhvillojnë biseda të shkurtra etj.. Gjatë kësaj kohe mësuesi shpjegon në forma të ndryshme fjalët e vështira e të reja, i drejton nxënësit që të gjejnë kuptimet e tyre të sakta, të para e të dyta, të gjejnë sinonimet e antonimet etj. Për këtë qëllim, përveç shpjegimit të mësuesit, ndihmojnë edhe objektet konkrete, figurat, si dhe përshtypjet nga ekskursionet dhe vizitat. E gjithë puna është që çështja të kuptohet drejt, se gjuha e folur dhe e shkruar mësohet para së gjithash, nëpërmjet pasurimit e zgjerimit të fjalorit dhe zhvillimit të ligjëratës së nxënësve. Prandaj, programi kërkon që nxënësit të arrijnë ta përdorin fjalorin e mësuar në të gjitha bisedat, në hartimet me gojë e me shkrim, si dhe në llojet e tjera të punëve me shkrim.

2. Veçoritë e punës në rubrikat “Bisedojmë së bashku”, “Fjalori

Puna për zhvillimin e të folurit me gojë e me shkrim të nxënësve, shtrihet jo vetëm në mësimet e gjuhës amtare, por edhe në mësimet e lëndëve të tjera, si dhe në të gjithë veprimtaritë mësimore-edukative në klasë dhe jashtë saj. Por punë me synime të mirfillta për pasurimin e fjalorit dhe zhvillimit të të folurit të nxënësve me gojë e me shkrim bëhet sidomos në mësimet që në tekstin e gjuhës amtare jepen përmes rubrikave “Bisedojmë së bashku” dhe “Fjalori”. Në këto mësimet në tekst janë paraqitur materiale të vlefshme, që shërbejnë si mbështetje për gjithë ecurinë e punës, siç janë ilustrimet me figura e tablo, fjalët e larmishme, ushtrime me zëvendësim fjalësh, me plotësim e formim fjalish, ushtrime për t'u punuar gojarisht e me shkrim, për punë të drejtpërdrejtë e të pavarur, për detyra shtëpie etj.

Këto rubrika, krahas rubrikave të gramatikës e të dretshkrimit, synojnë t'u mësojnë nxënësve gjuhën letrare kombëtare, që ata të bëhen të aftë ta përdorin atë me gojë e me shkrim, si mjet komunikimi në të gjitha veprimtaritë shoqërore. Gjatë këtyre rubrikave mësuesi duhet të ketë parasysh:

1. t'i studiojë më parë tablotë e figurat iluastuese, të zbulojë e të përcaktojë synimet mësimore edukative që ato kanë
2. të shqyrtojë fjalët e përdorura dhe të përcaktjnë në ç'kategori futen ato, ç'vend zënë në fjalorin e nxënësve, cilat janë krejtësisht të reja për ta, cilat kanë kuptime të dyta e të figurshme, cilat janë fjalë të fjalorit pasiv e cilat janë të njohura për nxënësit. Madje duhet pasur parasysh edhe diçka tjetër, që gjendja e fjalorit nuk është e njëjtë kudo p.sh. Në temën “Në pushime”, për nxënësit e vendeve të ulëta e bregdetare, fjalët: *det, valë, dallgë, breg* janë më të njohura, prandaj duhet të trajtohen në një mënyrë tjetër, kurse për nxënësit e zonave të thella malore ato herë-herë janë të panjohura. Me këtë sy shikohen të gjitha shtyllat e fjalëve të reja, sepse është e qartë se në mjaft drejtime fjalori i nxënësve nuk është i njëjtë në të gjitha trevat. Prandaj mësuesi duhet të thellohet në njohjen e këtyre veçorive, pasi vetëm kështu mund të drejtojë drejt punën metodike në klasë dhe mund të arrijë rezultate të mira. Përkundrazi kur mësuesi nuk i njeh këto probleme, atëherë do të kalojë ose në përsëritje fjalësh që nuk sjellin asgjë të re për fjalorin e nxënësve,

ose do t'i kalojë rrëshqitas disa fjalë që duhen punuar e ushtruar si elemente të reja.

Kërkohet, gjithashtu që mësuesi të njohë më për së afërmi edhe disa veçori dialektore që vërehen në të folurit me gojë e me shkrim të nxënësve, me qëllim që gjatë procesit mësimor të dijë se ku ta përqendrojë vëmendjen, cilat fjalë e shprehje t'i shpjegojë e t'i ushtrojë më gjerësisht e cilat prej tyre vetëm t'i përmendë. Është e qartë se pa një shkallëzim të tillë nuk mund të bëhet fjalë për rezultate të mira në punë.

Është e nevojshme që mësuesi të njohë mirë zhvillimin psikologjik e kulturor të nxënësve, sipas klasave, duke filluar që nga klasa e parë e deri në të katërtën, të ketë evidenca të sakta për përparimin e vazhdueshëm të nxënësve në fushën e fjalorit dhe ligjëratës me gojë e me shkrim. Ai, gjithashtu, të njohë mirë fjalët që paraqesin vështirësi për t'u kulturuar e për t'u përdorur nga nxënësit, siç mund të jenë fjalë që nuk njihen fare nga nxënësit, sidomos emra objektsh që nxënësit nuk i kanë parë asnjëherë, fjalë me kuptime sinonimike që nxënësit i njohin pjesërisht, fjalë me kutim të figurshëm që tregojnë sende abstrakte, në fjalë që nxënësit nuk mund t'i kuptojnë të shkëputura nga konteksti, termat tekniko-shkencorë të një sfare të caktuar, ndonjë fjalë e shprehje me kultime stilistikore, frazeologjike që nxënësit i dëgjojnë për herë të parë. Po këtë punë përgatitore mësuesi bën edhe me fjalët dhe shprehjet e ushtrimeve që paraqesin vështirësi jo vetëm nga ana kuptimore, po edhe fonetike, morfologjike e sintaksore. Ka rëndësi që mësuesi t'i njohë që më parë fjalë të tilla, si: **shëtitore, i padureshëm, i shkathët, madhështor** etj., që këmbëngulë në shqiptimin e drejtë të tyre. Ai të njohë edhe veçoritë e trajtatave morfologjike e sintaksore të fjalëve, lidhur me përdorimin e tyre në togfjalësha dhe në fjali.

Kërkohet gjithashtu, që mësuesi të ketë të dhëna për gjendjen e fjalorit të nxënësve edhe në lëndë të tjera, sepse puna për zhvillimin e të folurit të nxënësve me gojë e me shkrim shtrihet nga mësimet e gjuhë në të gjitha lëndët e tjera. Mësuesi me përvojë përcakton që më parë se cilat mund të jenë fjalët e shprehjet e reja në një mësim, cilat prej tyre do të përpunohen e do të shpjegohen në mënyrë të veçantë, cilat fjalë të bukura e shprehje, megjithëse të njohura duhen përpunuar që të bëhen pjesë e gjallë e e pandarë e të folurit të nxënësve etj. Po kështu edhe në lëndët e tjera, si dituri, matematikë, histori etj., mësuesi përcakton elementet e reja leksikore që kërkojnë shpjegime, që zgjerojnë e e përsosin më tej kulturën dhe shijen gjuhësore të nxënësve. Mësuesi duhet që gjatë përgatitjes të studjojë e të njohë mirë veçoritë ndërtimore të materialeve të tekstit mësimor dhe anën funksionale të tyre. Ai duhet ta ketë të qartë se pse është paraqitur ky ose ai objekt për ilustrim, përse vlen si mjet konkretizues, pse janë dhënë disa fjalë të shkëputura, përse janë marrë këto fjalë tj. Përveç kësaj mësuesi mund të përgatisë sipas rastit tabllo ilustruese, figura, ushtrime plotësuese të ndryshme nga ato të tekstit, copa për lexim etj.

Në bazë të këtyre përgatitjeve mësuesi ndërton edhe ecurinë metodike:

Fillohet vëzhgimin e figurave, tablove, që kryesisht kryhet në tri etapa: Së pari, kërkohet që nga një vëzhgim i tërësishëm e nxënësit duhet të thonë përshtypjet e përgjithshme dhe të përcaktojnë se çfarë dallojnë në tabllo. Në etapën e dytë kërkohet

që nxënësit t'i emërtojnë një nga një ato gjëra e fjalë që shohin. Këtu sipas rastit mësuesi ua përqendron vëmendjen nxënësve që të vërejnë cilësitë dhe veprimet e objekteve dhe t'i shprehin këto me fjalë. Mësuesi i ndihmon nxënësit me pyetje të përshtatshme për të krijuar një tërësi të plotë veprimesh në formë tregimi. Nxiten nxënësit që të përdorin fjalë të tjera të ndryshme nga të parat për të shprehur të njëjtin mendim. Mësuesi ngul këmbë për një shqiptim letrar të fjalëve, pa lejuar asnjë shmangieje dialektore. Kështu kur përdoret mbiemri **i bukur** nxiten nxënësit të thonë edhe fjalë të tjera me kuptim të njëjtë ose të përafërt p.sh **i hijshëm-i pashëm, i bukur-ishëmtuar**.

Nxënësit gjatë orëve të mësimit të lëndës “*Gjuhë amtare*” ndeshin fjalën **hartë**, të cilën mësuesi duhet që ta sqarojë, si harta ëpshtë një vizatim me kartë i një vendi, ku paraqiten të dhëna gjeografike, topografike p.sh harta e Shqipërisë, hartë arkeologjike etj. Apo në një orë modelimi ku nxënësi duhet që të mësojë të plotësojë një skedë, por ai akoma nuk di se ç’do të thotë fjala **skedë**, prandaj mësuesi sqaron **skedë=fletë e vogël prej kartoni, ku shkruhen të dhëna të ndryshme për librin. Skedat ndihmojnë për të gjetur në një kohë të shpejtë librat në bibliotekë**.

Shembull skede

Titulli:Pinoku

Emri i autorit:Karlo Kolodi

Lloji i librit: Përrallë

Numri i faqeve:100 fq.

Ngjyrat:me ngjyra

Pothuajse për çdo temë gjendet edhe rubrika “**Fjalor**” dhe nxënësi përveç shpjegimeve të mësuesit e ka të regjistruar edhe në libër fjalën e re. Por kur fjalët janë të shpjeguara në libër mësuesi u thotë nxënësve që ta regjistrojnë atë në fletoren e fjalorit. Njëkohësisht me fjalët e reja të mësuara u jepen nxënësve detyrë shtëpie që të formojnë fjali me to, apo të bëjnë një përshkrim a hartim të shkurtër.

Në vazhdim nxënësve u jepet një detyrë e pavarur. Në librat e “**Gjuhës amtare**” tabloja ose tema e diskutimit në rubrikën “**Bisedojmë së bashku**” jepen edhe mjaft fjalë **kyç** dhe me to kërkohet që të kryhen veprime të ndryshme psh. mund të kërkohet që të krijojnë fjali me këto fjalë duke ndryshuar formën: gjininë, numrin, rasën, vetën etj. Këto veprime i japin dorë përvetësimit dhe gjallërimit të fjalorit, i bëjnë nxënësit të jenë më të shkathët në përdorimin e fjalëve e fjalive në të folur e në të shkruar.

3. Forma pune për zhvillimin e të folurit me shkrim e me gojë të nxënësve

Për të pasur rezultate të mira në punën për zhvillimin e të folurit me gojë e me shkrim të nxënësve të klasave I-IV pas përgatitjes shkencore, pedagogjike e metodike të mësuesit,

një rëndësi të veçantë ka edhe përdorimi i formave të larmishme të punës. Disa prej këtyre formave, të ndara sipas klasave janë edhe këto:

- a) *Për klasën e parë*, ku mësimi i zhvillimit të folurit të nxënësve nuk zhvillohet në orë të veçanta, po shtrihet në të gjithë veprimtarinë mësimore e edukative në klasë e jashtë saj, përdoren forma pune, si: emërtimi i njerëzve dhe i kafshëve, sendeve në bazë të tablove dhe të figurave të paraqitura në tekstet mësimore dhe në fletoret e punës ose të zmadhuara të përgatitura nga mësuesi. Bëhet shpjegimi i kuptimit të fjalëve të reja që dalin nga leximi i pjesëve të abetares, të aritmetikës etj., shpjegimi i kuptimit të fjalëve të vështira që nxënësit i dëgjojnë, lexojnë etj. Bëhen përpjekje për krijimin e grupeve, kryesisht grupe emërore si p.sh **pemë e madhe, lule e bukur** dhe mësuesi i orienton nxënësit që të shpjegojnë edhe përshtatjen e mbiemrit me emrin në gjini, numër. I orienton nxënësit që të ndërtojnë fjali të thjeshta në bazë të figurave e të pyetjeve të mësuesit. Jepen edhe plotësime fjalësh me emra, mbiemra a folje. Mësuesi mund të punojë edhe pjesë nga librat jashtëshkollorë, por edhe me revistat e ndryshme që dalin për moshën e tyre. Metodë tjetër është edhe ritregimi i përrallave të shkurtra, punimi i gjëgjëzave etj.
- b) *Për klasën e dytë, të tretë e të katërt* ku puna për zhvillimin e folurit me gojë e me shkrim, bëhet nëpërmjet rubrikave të veçanta, por që shtrihet edhe në orët e gramatikës e të drejtshkrimit si dhe në lëndët e tjera, format e punës janë më të vështira. Forma pune janë: emërtimet e objekteve në bazë të figurave e tablove ose në bazë të vëzhgimit të tyre në natyrë. Për këtë qëllim nxënësit orientohen që fjalet e reja që emërtojnë njerëz, kafshë sende ose cilësi të tyre të ndahen në tri shtylla: emra, mbiemra, folje. Nxënësve u jepet detyrë shtëpie që ta pasurojnë fletoren e fjalorit me fjalë të reja që i lexojnë ose që i ndeshin gjatë bisedave të ndryshme. Me këto fjalë mësuesi bën një punë të veçantë në orët e lëndëve të ndryshme, sipas sferës që i përket këto fjalë, bëhet sqarimi i kuptimeve të drejtpërdrejta fjalëve dhe të kuptimeve të figurshme, duke i ballafaquar një herë të ndara një herë në kontekst. I kushtohet kujdes punës me sinonimet e me antonimet, me epitetet, krahasimet dhe shprehjet e bukura. Nxiten nxënësit që të krijojnë fjali me to. Pastaj nxënësit e udhëhequr nga mësuesi nxiten që të përshkruajnë një tablo, ku të përdoren edhe fjalët e reja, si psh, përshkrim i një dite pranvere, i një dite me dëborë etj. Bëhen ushtrime edhe për të ritreguar bukur pjesë të lexuara sipas roleve të personazheve, për të ritreguar përmbajtjen e një pjese me ndryshime formash gramatikoreme kthimin e ligjëratës së drejtë në të zhdrejtë e anasjelltas. Këtu rëndësi të veçantë ka dhënia e përpiktë e tremave dhe të ushtruarit e nxënësve që t'i përdorin me vend këto terma..

4. Puna me fjalorin dhe ligjëratën e nxënësve edhe në veprimtaritë jashtëshkollore

Puna për zhvillimin e fjalorit dhe të ligjëratës së nxënësve shtrihet edhe në veprimtari praktike e jashtëshkollore, si: në ekskursione, pasditet tematike, në punët praktike etj. Rëndësi ka që edhe këtu të punohet në mënyrë të planifikuar, të organizuar dhe synime të qarta, të cilat duhet të arrihen përveç të tjerash, edhe në zhvillimin me gojë e me shkrim të nxënësve.

Në ekskursionet mësimore nxënësit nxiten që të soditin pamjen e natyrës në përgjithësi, fshatin, qytetin, fushën, pyllin etj. Në një ditë pranvere, vjeshte ose dimri dhe përshtypjet e tyre t'i shprehin me gojë ose me shkrim. Të gjitha këto shërbejnë si materiale me shumë vlerë për hartimet e ndryshme me gojë e me shkrim. Gjatë ekskursiveve një punë e mirë bëhet edhe me fjalorin e nxënësve. Mësuesi u tërheq vëmendjen nxënësve që të vërejnë objektet përreth, pemët, bimët, lulet etj. I porosin që të mbledhin materiale për koleksione e në të njëjtën mënyrë i nxit që të mësojnë e të thonë emrat e tyre, veçoritë kryesore, pjesët përbërëse, formën ngjyrën si mbillen e si rriten, përse vlejnë etj. Në fund u jepet detyrë nxënësve që fjalët e reja t'i shkruajnë në fletoren e fjalorit. Punën me materialet e mbledhura mësuesi e vazhdon edhe në klasë. Në lëndë të ndryshme mësimore p.sh. dituri natyre, po edhe në mësimin e gjuhës amtare mësuesi u kërkon nxënësve t'i thonë fjalët e reja të mësuara e t'i përdorin edhe në bisedat e detyrat me shkrim. Realizohet në këtë mënyrë edhe lidhja ndërëndore.

Edhe gjatë ekskursionit mësimor, por edhe gjatë orëve të mësimin, mësuesi punon më tej për ngulitjen e fjalëve të reja, midis tyre edhe të termave shkencorë, të cilat nxënësi i gjen edhe në tekstet mësimore. Mësuesi u sqaron fillimisht nxënësve se çdo të thotë fjala **term**= *që është emërtimi i me një fjalë apo me një togfjalësh i një koncepti në një fushë të shkencës, teknikës, të artit.*